

AKTIVITET 8

VIZITË NË QENDRËN RINORE “ATELIE”, BASHKIA SHKODËR

Në kuadër të projektit tonë të Edukimit të Karrierës vizita e radhës ishte në Qendrën Rinore “Atelie” të Bashkisë Shkodër. Ajo është një nga organizatat më mbështetëse në hapat e karrierës së çdo nxënësi të talentuar në çfarëdolloj prirjeje.

Synimi ishte njohja me shërbimet e ofruara nga kjo qendër si: punësimin, organizimet rinore, çështjet sociale, etj.

Nxënësit u njohën me laboratorët, sallën e kinemasë dhe teatrit, sallën e muzikës, sallën e vallëzimit, sallën e pikturës dhe bibliotekën .

Ata panë punime e veprimtari cilësore që nxënësit pjesëmarrës të kësaj qendre kishin organizuar me shumë përkushtim.

Gjetëm aty nxënës të talentuar që po hidhnin hapat e para të karrierës sipas orientimit dhe talentit të tyre. Gjithashtu, ftuam nxënësit e tjerë të talentuar të bëhen pjesë e kësaj qendre.



